



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione  
Nr. 0-14  
Prishtinë, më 24. 6. 2008, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**P R O C E S V E R B A L**

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione

**Morën pjesë:** Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Sanije Alijaj,  
Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim  
Rrustemi dhe Vezira Emrush - anëtarë.

Të ftuar:

Hilmi Zhitia nga Prokuroria e Republikës së Kosovës  
Prenk Gjetaj, kryetar i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur,  
Tomë V. Gashi, avokat nga Prishtina dhe  
Ministria e Drejtësisë që nuk iu përgjigj ftesës.

**Mediat:**

Edona Peci -Alsat, Sylë Ahmeti - “Kosova Sot”, Besnik Salihu – “Kosava live”, Bukurije  
Baraliu - “Koha ditore”, Elita Vokshi - OSBE, Fitore Zeneli - KDI, Besiana Krasniqi -  
RTV-21 dhe Valdete Osmani - KTV.

Rrahim Demaj nga stafi mbështesë i Komisionit .

Kryetari ia propozoi Komisionit këtë

## **REND DITE**

1. Mbledhja e Komisionit me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, me kryeprokurorin e Republikës së Kosovës, me kryetarin e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur dhe me Tomë V. Gashit, avokat, lidhur me ecurinë e ngritjes së kallëzimeve penale kundër kryesve të krimeve të bëra gjatë luftës në Kosovë,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

1. Mbledhja e Komisionit me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, me kryeprokurorin e Republikës së Kosovës, me kryetarin e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur dhe me Tomë V. Gashit, avokat, lidhur me ecurinë e ngritjes së kallëzimeve penale kundër kryesve të krimeve të bëra gjatë luftës në Kosovë,

*U hap diskutimi për pikën e parë:*

**Ismet Beqiri** – I përshëndeti të ftuarit që iu kishin përgjigjur ftesës si dhe mediat që po e përcjellin këtë takim. Komisioni kërkoi të mbahet dëgjim për shqyrtimin e peticionit të Tomë V. Gashi, përfaqësues i së dëmtuarës znj. Lutfije Behrami nga Vushtrria, lidhur me kallëzimin penal nr. 428-8-2 të datës 25. 3. 1999, kundër kryesve të krimeve. Pra, nuk është vetëm kjo ngjarje, por ka edhe të tjera si ajo e Dubraves së Istogut në lidhje me masakrën e bërë mbi të burgosurit. Krimi është krim, nuk njeh ngjyrë as racë. Autorët e krimit duhet të vihen para organeve të drejtësisë dhe t'u shqiptohet dënimi i merituar. Ai e ftoi kryeprokurorin e Republikës së Kosovës që ta marrë fjalën.

**Hilmi Zhitia** – Kryeprokuror i Kosovës, shkurtimisht e përshkroi punën e prokurorive të qarqeve të Kosovës si vijon: Deri tani janë ngritur 1000 aktakuza penale kundër kryesve të krimeve të luftës. Numri i gjykimeve të të dyshuarve për krimet e bëra, duke i përfshirë edhe ato raste për të cilat nuk ka pasur fakte të ofruara nga pala akuzuese, është vogël. Ai duke e tërhequr një paralele sipas bazës etnike të të akuzuarve dhe të të gjykuarve të deritashëm për krimet e luftës në Kosovë, del se më i madh është numri i shqiptarëve që është nxjerrë në gjykim se sa i serbëve. Ajo që veçoi ishte se nga serbët e akuzuar më shumë ka pasur aktakuza të ngritura nga vetë shteti serb se sa kanë ngritur gjykatat e Kosovës.

**Prokuroria Publike e Qarkut e Prizrenit** – I ka paraqitur katër aktakuza, me të cilat janë akuzuar katërmëdhjetë persona, njëmbëdhjetë serbë dhe tre shqiptarë. Prej tyre janë dënuar dy: njeri me 20, ndërsa tjetri me pesë vjet burg. Dy janë liruar nga aktakuza, ndërsa për katër të tjerë është hequr dorë nga ndjekja penale. Të tjerët janë të pakapshëm për organet e ndjekjes penale. Në procedurë të hetimeve janë 22 persona, prej të cilëve 14 serbë.

**Prokuroria e Qarkut e Mitrovicës** - Ka akuzuar 8 persona. Janë dënuar dy prej tyre: njeri 14 vjet, ndërsa tjetri 20 vjet burg. Në arrati gjenden pesë. Për 26 persona është paraqitur kërkesa për zhvillimin e hetimeve. Me këtë shihet se në vitin 2004 Prokurorisë

Komunale i janë kthyer 4500 lëndë, që ende pa filluar hetimet kanë kaluar te ndërkombëtarët.

**Prokuroria Publike e Qarkut e Pejës** - Në vitin 2001, konform dispozitave të nenit 142 të LPJ, ka iniciuar zhvillimin e hetimeve kundër 149 serbëve, dy myslimanëve dhe dy shqiptarëve. Disa kallëzime penale kanë kaluar te ndërkombëtarët.

Në vitin 2001 Prokuroria ka ngritur kallëzime penale kundër 102 serbëve, kundër dy myslimanëve dhe kundër dy shqiptarëve. Në vitin 2002 janë ngritur kallëzime penale kundër 133 serbëve, kundër një boshnjaku dhe kundër tre shqiptarëve.

Ne vitin 2003 Prokuroria ka ngritur 18 kallëzime penale kundër pjesëtarëve të komunitetit serb. Në vitin 2004, është kërkuar të kryhen hetime për 67 serbë, për dy myslimanë dhe për dy shqiptarë. Kësaj Prokurorie i janë paraqitur 71 kallëzime penale kundër 577 serbëve, kundër 9 myslimanëve, kundër 9 shqiptarëve dhe kundër 7 romëve.

**Prokuroria Publike e Qarkut e Gjilanit** – Në vitin 2000 ka ngritur dy aktakuza kundër Momçillo Trajkoviqit dhe Millosh Nikoliqit. Edhe pse Gjykata ua ka shqiptuar dënimet, këto lëndë gjenden të ndërkombëtarët, mirëpo u dënuan Bozhidar Stojanoviqi dhe Agim Ajeti, që më vonë u liruan. Ndërsa në vitet 2002, 2004 dhe 2006 Prokuroria ka kryer hetimin për kallëzim penal për zbulimin e kryesve të veprave penale, në të cilin përfshihen më se 100 persona. Kjo lëndë tani gjendet te znj. Elizabet Ren në cilësi të prokurores ndërkombëtare.

**Prokuroria Publike e Qarkut e Prishtinës** - Ka ngritur 6 aktakuza: dy persona janë liruar, ndërsa katër aktakuza u janë proceduar prokurorëve ndërkombëtarë. Kryeprokurori ka kërkuar nga homologu i tij në EULEX informatë rreth numrit dhe procedimit të lëndëve për krime në Kosovë. I është thënë se informatat e tilla do të hyjnë në kuadër të njësitit special (EULEX) që do të merret me krimet e luftës.

Në fund ceku se ka pasur konflikte ndërmjet vendorëve dhe ndërkombëtarëve lidhur me zgjidhjen e lëndëve. Kemi pasur pengesa nga ndërkombëtarët se një gjë të tillë ua ka mundësuar policia UNMIK-ut që komunikon me prokurorët ndërkombëtarë.

**Tomë V. Gashi** - E hodhi poshtë arsyetimin e kryeprokurorit sa i përket konfliktit të vendorëve dhe të ndërkombëtarëve. Atë është dashur ta zgjidhnin instancat më të larta, të cilave askush nuk u ka ndalur t'i drejtohen UNMIK-ut për të kërkuar sqarime lidhur me ngecjen e tyre.

**Z. Pren Gjetaj** – Kryetar i Komisionit Qeveritarë për Personat e Pagjetur, nënvizoi se kjo kategori ende trajtohet në kuadër të ligjit të përbashkët për familjarët e dëshmorëve. Në këtë drejtim ngriti çështjen e hartimit të Projektligjit për personat e pagjetur dhe premtoi se së shpejti kjo fushë do të rregullohet me ligj të veçantë. Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit për Projektligjin, disa anëtarë e demantuan se nuk është ndërmarrë kurrfarë veprimi nga Ministria e Drejtësisë.

**Tomë V. Gashi** – Këshilltar ligjor i Kryeministrit të Kosovës, që e përfaqëson të dëmtuarën z. Lutfije Behrami nga Vushtrri dhe që ka ngritur kallëzim penal kundër anëtarëve të Shtabit të Krizës të formuar nga Republika e Serbisë, rrethi i Mitrovicës, nr. 428 – 82 të datës 25. 03. 1999, i njoftoi të pranishmit për peticionin nr. 02-3717 të datës 30. 08. 2007. Shkurtimisht i njoftoi të pranishmit se si ka arritur deri të kontakti me palën

e viktimizuar. Duke u ndërlidhur me raportin dhe diskutimin e kryeprokurorit adresoi kritika kundër institucioneve të vendit për mosngritjen e asnjë aktakuze penale ndaj kryesve të kimit gjatë luftës në Kosovë, njëkohësisht edhe për mosshtrimin e trysnisë në institucionet ndërkombëtare që ky proces të mos zvarritet. Kërkoj që edhe më tutje të grumbullohen provat dhe atë që e dimë privatisht ta shndërrojmë në prova dhe të procedohet më tej.

**Ismet Beqiri** – Kryetar duke u ndërlidhur me të dhënat e paraqitura nga z. Zhitia, shtoi: Në bazë të procesit të deritashëm që është përcjellë rreth kallëzimeve penale të ngritura për krime lufte në Kosovë, Komisioni nuk është i kënaqur me punën e bërë deri më tani. Fakte ka, por veprime për arrestimin e të dyshuarve nuk po ndërmerren. Ata po shëtisin të lirë nëpër Kosovë. Ceku se në të kaluarën ka pasur edhe seleksionime lidhur me zgjidhjen e lëndëve. Tha se pak është bërë te ndërkombëtarët dhe në këtë drejtim ka pasur servilizëm të paarsyeshëm ndaj prokurorëve dhe apeloj te institucionet të marrin masa se krimi nuk njihet kufij.

Kryetari i përshëndeti të ftuarit për kontributin e dhënë dhe i ftoi anëtarët të parashtrajnë pyetje.

**Prof. dr. Nerxhivane Dauti** - I përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi për përmbajtjen e peticionit që më parë e ka shqyrtuar dhe i ka rekomanduar Komisionit për organizimin e dëgjimit. Shkurtimisht i njoftoi ata për punën e bërë të Komisionit për zgjidhjen e peticioneve. Ajo kërkoj të jepet informacion i qartë lidhur me peticionin që pastaj pala të informohet. Në fund kërkoj nga Komisioni që diskutimet të orientohen rreth peticioneve dhe pikës së rendit të ditës.

**Hajredin Hyseni** - Duke u ndërlidhur me parafolësit, vuri në pah: Në Kosovë janë bërë krime të shumta për të cilat ka fakte dhe prova, por deri më tani institucionet e Kosovës në këtë drejtim kanë bërë pak në ngritjen e kallëzimeve penale. Pastaj e shtroi pyetjen: A e ka penguar kush Prokurorinë Publike të Kosovës të ngritë kallëzim penal kundër kryesve të krimeve në Burgun e Dubravës, me ç'rast Serbia i masakroi më se 160 persona dhe 300 i plagosi.

**Z. Ibrahim Makolli** - Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve shkurtimisht e paraqiti gjendjen dhe u pajtua se në këtë drejtim ka pasur ngecje të procedurave, si nga vendorët ashtu edhe nga ndërkombëtarët. Duke e kërkuar ndriçimin e tyre deputetet Sanije Alijaj dhe Luljeta Shehu i shtruan pyetje dhe morën përgjigje që u mirëpritën.

Ishte konstatim i përgjithshëm se numri i gjykimeve kundër kryesve të krimeve të luftës është shumë i vogël. Nuk janë të kënaqur me punën e Prokurorisë që është bërë deri tani si dhe me arrestimet e kryesve të krimeve që shëtisin të lirë nëpër Kosovë. Gjithashtu doli konstatimi se takimet e këtilla janë të dobishme dhe e ndihmojnë Komisionin për zgjidhjen peticioneve.

U vendos që Komisioni në mbledhjen e ardhshme t'i nxjerrë përfundimet që dolën nga kjo mbledhje.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryesuesi ,konstatoi se Komisioni miratua miratoi procesverbalin të datës 20.6.2008 pa vërejtje.*

E përgatitur nga

Rrahim Demaj - zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit  
Ismet Beqiri